# BASHKIA TEPELENË




## PAKETA FISKALE 2018

© DHJETOR 2017
WWW.TEPELENA.GOV.AL

REPUBLIKA E SHQIPERISE

KESHILLI BASHKIAK

TEPELENE

---

VENDIM

NR. 41 DATË 21/12/2018

# PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE TË BASHKISË TEPELENE PËR VITIN 2018

Mbështetur në gërmën "f", të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",

në ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar me Ligj Nr. 106/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,"Për Sistemin e Taksave Vendore", të ndryshuar;

ligjit 68/2017 "Per Financat e Vetqeverisjes Vendore

në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,

në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",

ligjin nr 10081 ,date 23.02.2009"Per licensat,autorizimet dhe lejet ne RSH , i ndryshuar

ligjin nr 10456 date 29.09.2011"Per sherbimin veterinarise ne RSH, in dryshuar

ligjin 8450 date 24.02.1999"per perpunimin ,transportimin dhe tregetimin e naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre" i ndryshuar

Ligjit 9385 date 04.05.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor i ndryshuar

Ligjit 9693 date 19.03.2007 "per fondin kullosor"i ndryshuar

Ligjit 10463 date 22.09.2011 "per menaxhimin e integruar te mbetjeve"i ndryshuar

VKM nr 285 date 27.06.2002 "per tarifat e sherbimeve qe kryen PMZSH...."

VKM 707 ,date 12.10.2016 " per tarifen e SHMZSH te ofruar nga bashkite e pajisura me stacione te ketij sherbimi ,ne territorin e bashkive qe nuk kane stacione.

VKM Nr 784, datë 9.11.2016 për mënyrën dhe kriteret e llogaritjes së shpenzimeve të ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruara nga zjarri dhe administrimin e përdorimin e të ardhurave, për llogari të shërbimit vendor të mzsh-së

ligjin 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin",

ligjin Nr. 24/2017 "Për Administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit",

neni 15 i ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor" (i ndryshuar); neni 32,

pikat 7 dhe 8 të Rregullores Nr. 22 AKEP, datë 24.06.2011 "Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike" (e ndryshuar); neni 10, pika 3 e neni 12 i ligjit 10.279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative" Këshilli i Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

**<u>VENDOSI:</u>**

**A. TAKSAT VENDORE**

**I.** Të miratojë sistemin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Tepelene si vijon:

**II.** Të gjitha Vendimet e Këshillit Bashkiak që bien në kundërshtim me këtë akt, shfuqizohen.

## 1. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PER BIZNESIN E VOGEL

Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave. Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor."

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me qarkullim vjetor nga 5 deri në 8 milionë, është 5% dhe për subjektet me qarkullim vjetor nga 0 deri në 5 milionë lekë, është 0 lekë në vit. *Sektori I Zhvillimit Ekonomik (Taksa-Tatime ), nëpërmjet drejtorise rajonale tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogarite e buxhetit të qeverisjes vendore brenda datës 10 të muajit pasardhës ,kur janë arkëtuar të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.*

Administrata Tatimore Qëndrore për shërbimin qe kryen merr nje komision ne masën 1% të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe transferuar në buxhetin e qeverisjes vendore.

## 2. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME.

Në këtë zë përfshihen **Taksa mbi ndërtesën, Taksa mbi tokën bujqësore dhe Taksa mbi truallin**.

**2.a) per periudhen 1 janar -31 mars 2018 do te vijoje te zbatohet keto nivele takse.**

| Kategoritë minimale të ndërtesave | Lekë/m² në vit |
|---|---|
| I. Ndërtesa banimi | |
| - ndërtuar para 1993 | 5 |
| - ndërtuar gjatë dhe pas 1993 | 6 |
| II. Ndërtesa të tjera | |
| - Për tregti dhe shërbime | 200 |
| - Të tjera<br>Ndërtesat në pronësi ose në përdorim të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve.Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit, si dhe sipërfaqe objektesh të pashfrytëzuara ku nuk zhvillohet aktivitet. | 40 |
| Ndërtesa që përdoren për veprimtari prodhuese | 100 |
| III. Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike. | 400 |

**2.b per periudhen 01 prill 2018 me hyrjen ne fuqi te ndryshimeve te ligjit per taksat vendore, do te aplikohet ne keto nivele Taksa mbi ndërtesën. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave**

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë: a) 0,05 % për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim; b) 0,2 % për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike; c) 30 % e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

1. **Njësia e vetëqeverisjes vendore** është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, përmes ushtrimit të funksioneve të mëposhtme: a) mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale; b) përditësimin e të dhënave të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra

Fiskale); c) mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën; ç) korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj.; d) shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.

*2. Taksa mbi ndërtesën, sipas dispozitave të ligji, mund të mblidhet nëpërmjet agjentëve të taksave, të cilët kanë shtrirje territoriale, sistem elektronik të bazës së të dhënave e të gjenerimit të detyrimeve dhe që autorizohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore. Këshilli i Ministrave përcakton edhe masën e përfitimit të agjentit të autorizuar, mbi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e ndërtesave. 3. Të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme derdhen për llogari të buxhetit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, dhe përdoren në përputhje me ligjin "Për financat e vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.".*

**2.b) Taksa mbi tokën bujqësore.**

Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor dhe paguhet brenda datës 30 qershor të vitit fiskal. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës në hektarë, në pronësi të taksa paguesit. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

| Klasifikimi sipas kategorise se Tokes bujqesore | Vlera e Takses leke/hektare Vit |
|---|---|
| I | 2800 |
| II | 2100 |
| III | 1400 |
| IV | 1350 |
| V | 1250 |
| VI | 1200 |
| VII - X | 1100 |

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka. Pas vetëdeklarimit Sektori i Zhvillimit Ekonomik ( Tatim-Taksa ) mund të bëjë verifikimin në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përllogaritet për të gjithë periudhën.

**Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.**

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Sektori I Zhvillimit Ekonomik (Tatim-Taksa) per njesinë Administrative Tepelene, kurse për njësitë e tjera administrative, struktura e ngarkuar është njësia administrative. Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

**2.c) Taksa mbi truallin.**

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në hektar, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit, është detyrim vjetor dhe paguhet brenda datës 30 qershor të vitit fiskal. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Pas vetëdeklarimit Drejtoria e të Ardhurave mund të bëjë verifikimin në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përllogaritet për të gjithë periudhën. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi truallin është si vijon:

| Klasifikimi Sipas Bashkive | Vlera e takes ne leke/m2/vit per qellime banimi nga Individet | Vlera e takses ne leke/m2/vit per qellime biznesi |
|---|---|---|
| Bashkia Tepelene | 0.28 | 15 |

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për biznesin është Sektori i Zhvillimit Ekonomik (Tatim-Taksa). Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për familjarët, agjenti tatimor Ujsjelles Kanalizime Tepelene,(për njësinë administrative Tepelene), kurse për njësitë e tjera administrative, struktura e ngarkuar është njësia administrative.

## 3. TAKSA E FJETJES NË HOTEL.

Me **"hotel"** kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara

në hotel, për person. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel".

| Kategorite minimale te takses se fjetjes ne Hotel | Bashkia Tepelene |
|---|---|
| Hotel me 4-5 yje | 175 leke per nate fjetje |
| Bujtine,fjetinë,motel,dhe cdo njesi tjeter akomoduese, sipas percaktimeve te ligjit per turizmin | 35 leke per nate fjetje |

Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës. Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Sektori i Zhvillimit Ekonomik (Tatim-Taksa) prane Bashkise Tepelene.

## 4. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA.

| NR | EMERTIMI I SHERBIMIT | SPECIFIKIME | NJESIA | VLERA E TAKSES |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Leje ndertimi | Me funksion dhe aktivitet, Banim. | leke | 4%<br>vleres se shitjes |
| | | Me funksion dhe aktivitet, Njesi Sherbimi (perfshire garazhe, kabina<br>elektrik) te perkohshme dhe perhershme | leke | Lekë 6%<br>e vleres se shitjes |
| 2 | Leje për ndryshimin e aktivitetit dhe funksionit te objektit | Me funksion dhe aktivitet, nga Banim ne Njesi Sherbim | leke | Lekë 6%<br>e vleres se preventivit |
| | | Me funksion dhe aktivitet, nga Njesi Sherbimi ne Banim | leke | 4%<br>e vleres se preventivit |
| 3 | Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi | Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi Leje Ndertimi. Deklarate paraprake per kryerje punimesh | leke | Lekë 0.5<br>e vleres se investimit |

A. Baza ligjore e ne te cilen operon DPKZHT eshte kryesisht ligji nr.107/2014 date 31.07.2014 "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, si dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

*Baza ligjore per percaktimin e Takses se Ndikimit ne Infrastrukture eshte ligji nr.142/2015, datë 17.12.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa" në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.*

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.
2. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 % dhe 6 % të çmimit të shitjes për metër katror (e specifikuar tek tabela e mesiperme). Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.
3. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është 2% e kësaj vlere.
B. Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1% e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5% e vlerës së investimit.
4. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblidhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.
5. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.".
6. Pagesa e taksave sipas tabeles se mesiperme (per piken 1 dhe 2)) do të kryhet pas miratimit të vendimit, por jo më vonë se 15 ditë. Dokumenti i Lejes dorezohet zhvilluesit pasi eshte kryer kjo pagese.

*Struktura e ngarkuar për përllogaritjen, vjeljen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Tepelene.*

## 5. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

- Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

- Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Kategoritë e ndërtesave, për efekt të bazës së taksueshme, jepet në tabelën e mëposhtme. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi llogaritët si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

- Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritët si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

- Vjelja e kësaj takse bëhet nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), të cilat, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3 për qind të shumës së arkëtuar.

Niveli i taksës sipas ligjit nr.9632 dt.30.10.2006, me ndryshime, është si më

poshtë:

| Kategoritë e Ndertesave | Njësia Administrative Tepelenë | Njësite e tjera Administrative |
|---|---|---|
| | Zona 3 (leke/m2)+ 30% | Zona 3(leke/m2) |
| I. Ndertesa banimi | 100 +30 **130** | 100 |
| II. Ndertesat e tjera per tregeti dhe sherbime. | 300 +90 **390** | 300 |
| III. Te tjera ndertesa | 200 +60 **260** | 200 |

## 6. TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA.

Drejtoritë Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat janë agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbledhin këtë taksë dhe e derdhin, brenda datës 30 të çdo muaji, për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njësive të qeverisjes vendore. Drejtoria rajonale e shërbimeve të transportit rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njësive të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin e taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit. Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoritë rajonale të DRSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të të ardhurave, derdhin me anë të faturës për arkëtim, 25(njezet e pese)% të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore, dhe 82 (tetëdhjetë e dy)% të të ardhurave, DPSHTRR-ja e derdh për llogari të drejtorisë rajonale, ku është regjistruar (drejtoria rajonale e tatimpaguesve të mëdhenj). Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

*Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor.*

## 7. TARIFE PËR LINJAT AJRORE DHE NËNTOKËSORE (TELEFONI, ENERGJI, TV KABLLOR, INTERNET)

Baza e taksës për linjat ajrore dhe nëntokësore është gjatësia lineare për kilometër e linjave ajrore dhe nëntokësore e cila vihet në shfrytëzim nga subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksa paguesit duke shumëzuar bazën e taksës (gjatësinë lineare për kilometër) me nivelin tregues të saj.

Niveli i kësaj takse për Bashkinë Tepelene është 1.000 lekë/km/vit për linjat nëntokësore dhe 2.000 lekë/km/vit për linjat ajrore. *Struktura e ngarkuar për përllogaritjen e taksës së përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore është Drejtoria e Kontroll Territorit të Bashkisë Tepelene dhe për vjeljen e saj është Sektori i Zhvillimit Ekonomik (Taksa-Tatime) Bashkia Tepelene.*

## 9. TAKSA E TABELËS.

9.a) per periudhen 1 janar - 31 mars 2018 do te vijoje aplikimi me keto nivele takse:

| Kategoritë | Niveli i taksës |
|---|---|
| 1) Tabelë për qëllime identifikimi: | 0 lekë/vit |
| a) Tabelë për qëllime identifikimi, deri në 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. | 45 000 lekë/m2 |
| a.1) Tabelë për qëllime identifikimi mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. | 120 lekë/vit |
| b) Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim | |
| 2) Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe e palëvizshme: | |
| Për bashkitë qendër qarku | |
| - Tabelë e thjeshtë | 13.500 leke/m2/ vit |
| - Tabelë elektronike | 27.000 leke/m2/vit |
| 3) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj. | 1000 leke/m2/vit |

9.b) per periudhen 01 prill 2018 me hyrjen ne fuqi te ndryshimeve te ligjit per taksat vendore Kjo taksë do te aplikohet për të gjitha subjektet fizike, juridike, private e shtetërore, vendas apo

të huaj që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Bashkisë Tepelene. Niveli i kësaj takse për Bashkinë Tepelene si bashki e kategorisë së tretë(III) është si më poshtë vijon :

| Kategorite | Nj/matese | Niveli Takses |
|---|---|---|
| 1) Tabelë për qëllime identifikimi , të trupëzuara ose jo, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëvë( ku shenohet emir dhe veprimtaria e të tretëve): | | |
| a) Tabelë për qëllime identifikimi, deri në 2 metra katror, | lekë/m2/vit | 0 ( Zero ) |
| b) Tabelë për qëllime identifikimi mbi 2 metra katror, deri 10 m2<br>- e thjeshte ( pa ndricim)<br>- me ndricim e thjeshte<br>-elektronike | lekë/m2/vit | 7 000<br>11 500<br>15 000 |
| c) Tabelë për qëllime identifikimi mbi 10 metra katror, deri 20 m2.<br>- e thjeshte ( pa ndricim)<br>- me ndricim e thjeshte<br>-elektronike | lekë/m2/vit | 5 950<br>9 775<br>12 750 |
| ç) Tabelë për qëllime identifikimi mbi 20 metra katror, deri 40 m2.<br>- e thjeshte ( pa ndricim)<br>- me ndricim e thjeshte<br>-elektronike | lekë/m2/vit | 3 850<br>6 325<br>8 250 |
| d) Tabelë për qëllime identifikimi mbi 40 m2<br>- e thjeshte ( pa ndricim)<br>- me ndricim e thjeshte<br>-elektronike | lekë/m2/vit | 2 800<br>4 600<br>6 000 |
| II.Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet vevrimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim.<br>Tabela identifikuese | lekë/m2/vit | 120 |
| III. Tabela për qëllime reklamimi e lëvizëshmee pa lëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m2<br>- e thjeshte ( pa/me ndricim)<br>-elektronike | lekë/m2/vit | 13 500<br>27 000 |
| IV.Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire,spektakle,stenda reklamuese, banderola etje.<br>- Të të gjitha llojeve dhe përmasave | lekë/m2/vit | 1 000 |

Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10m2, shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri në 10 m2 do t'I shtohet , shuma e taksës e llogaritur për diferencën e sipërfaqes së mbi 10m2 shumzuar me tarifën përkatese të taksës.

Për subjektet taksa paguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga dy tabelat identifikues do të konsiderohet e tillë, kurse tjetra do të konsiderohet si reklamë.

Çdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen prej 35 m2 ,do të konsiderohet sikur është 35m2 dhe shuma e taksës llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe, pavarsisht madhësisë së saj më të madhe në m2.

Në kategorinë e raklamës kuptojmë cdo publicitet , formë promovimi që shërben për të njoftuar ,tërhequr vëmendjen ose joshur blerësit, të vendosur në pamje jo ballore, në tarracë,lozhë, ballkone, në pjesë teë rrugës, shtylla, që kanë përmbajtje me qëllimëe reklamimi pqr vete e për të tjerë.

Detyrimi i kësaj takse është vjetor dhe pagesa bëhet paralelisht me pagesën e taksave dhe tarifave të tjera. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë në favor të bashkisë, bëhet brenda datës 20 Prill të vitit fiskal. Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. *Struktura e ngarkuar për dhënie leje për të vendosur tabelë reklamuese është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Tepelene bazuar në kërkesën e subjektit që do të vendosë tabelë reklamuese. Struktura e ngarkuar për identifikim, matjen dhe përllogaritjen e kësaj takse është Drejtoria e Kontrollit të Territorit. Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Sektori i Zhvillimi Ekonomik (Tatim-Taksa) bashkia Tepelene. Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje me lejë për vendosje tabele reklamuese është Policia Bashkiake.*

## 10. DHËNIE E LIÇENCAVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS BRUTO DHE NËN PRODUKTEVE TË SAJ.

Bazuar në Ligjin Nr.8450, datë 24.2.1999 "Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregëtimin e Naftës, të Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre" të ndryshuar me Ligjin Nr .9218, datë 08.04.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 "Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregëtimin e Naftës, të Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre", si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 129, datë 18.03.1999 "Për proçedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e të nënprodukteve të tyre" të ndryshuar me Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 170, datë 25.04.2002 & Nr. 563, datë 27.08.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime për proçedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e të nënprodukteve të tyre",VKM nr. 970, datë

"Përcaktimin e 10 procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nën produkteve të saj" Bashkia Tepelene jep liçence për personat juridikë të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregëtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkisë Tepelene. Autorizimet jepen nga Bashkia Tepelene për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet me të drejtë përsëritjeje dhe pagesa për dhënie autorizimi për dy kategoritë e mësipërme është si më poshtë vijon.

- Pagesë për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjete dhe vajra lubrifikante 1 000 000 lekë
- Pagesë për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregëtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët *fundorë 50 000 lekë.*

*Struktura e ngarkuar për dhënien e kësaj liçence dhe vjeljen e detyrimit është Sektori i Zhvillimit Ekonomik (Tatim-Taksa) Bashkia Tepelene.*

*Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje dhe mos zbatim të saj (bazuar në rregulloret përkatëse)* ***është Policia Bashkiake***

## B.TARIFAT VENDORE

| 1 | LLOJI I TARIFES | VLERA |
|---|---|---|
| | **TARIFE PASTRIMI,LARGIMIT E KOMPESIMIT TE MBETURINAVE**<br>➢ Cdo familje në njësinë administrative Bashkia Tepelene<br>➢ Cdo familje në njësinë administrative Qender<br>➢ Cdo familje në njësinë administrative Kurvelesh<br>➢ Cdo familje në njësinë administrative Lopes<br>➢ Cdo institucion shteteror,shoqate jofitim prurese e te ngjashme.<br>➢ Per cdo njesi, dyqan mishi, peshku, bulmet, perime, mallra konsumi,materjale ndertimi, profesionet e lira farmaci, , hotele, lavazho, gomist etj si keto.<br>➢ Per cdo njesi klinik dentare<br>➢ Per cdo njesi, me aktivitet, kontabilist,avokat,noter, kancelari, kinkaleri, bizneset e artit, shitje rroba e te ngjashme me keto.<br>➢ per cdo njesi bar restorante, bar kafe e te ngjashme me leto.<br>➢ shoqerite e sigurimeve dhe transferta parash dhe te ngjshme me keto.<br>➢ Per cdo subjekt juridik, privat .shpk,sha, e te ngjashme me keto. | 100 leke ne vit<br>50 leke ne vit<br>50 leke ne vit<br>50 leke ne vit<br>10.000 leke ne vit<br>5.000 leke ne vit<br>3.000 leke ne vit<br>2.000 leke ne vit<br>4.500 leke ne vit<br>5.000 leke ne vit<br>20.000 leke ne vit |

| | | |
|---|---|---|
| | ➢ Per cdo njesi, gurore furrat e gerqeles e tje si keto.<br>➢ Per cdo njesi supermarketi.<br>➢ Per tregetaret ambulant. | 20.000 leke ne vit<br>20.000 leke ne vit<br>300 leke ne vit |

*Struktura e ngarkuar per vjeljen e kesaj tarife eshte Sektori i Zhvillimit Ekonomik per njesine Administrative Bashkise Tepelene, per tarifat e familjeve jane sportelet e ujesjelles Kanalizimeve Tepelene, per vjeljen e kesaj tarife ne Njesite e tjera administrative jane vete Njesite administrative.*

| 2 | LLOJI I TARIFES | VLERA |
|---|---|---|
| | **TARIFA E NDRICIMIT RRUGOR** | |
| | ➢ Cdo familje në njësinë administrative Bashkia Tepelene | 100 leke ne vit |
| | ➢ Cdo familje në njësinë administrative Qender | 0 leke ne vit |
| | ➢ Cdo familje në njësinë administrative Kurvelesh | 0 leke ne vit |
| | ➢ Cdo familje në njësinë administrative Lopes | 0 leke ne vit |
| | ➢ Cdo institucion shteteror,shoqate jofitim prurese e te ngjashme. | 5.000 leke ne vit |
| | ➢ Per cdo njesi, dyqan mishi, peshku, bulmet, perime, mallra konsumi,materjale ndertimi, profesionet e lira farmaci, klinik dentare, hotele, lavazho, gomist etj si keto. | 2.500 leke ne vit |
| | ➢ Per cdo njesi, me aktivitet, kontabilist,avokat,noter, kancelari, kinkaleri, bizneset e artit, shitje rroba e te ngjashme me keto. | 2.500 leke ne vit |
| | ➢ per cdo njesi bar restorante, bar kafe e te ngjashme me leto. | 2.500 leke ne vit |
| | ➢ shoqerite e sigurimeve dhe transferta parash dhe te ngjshme me keto. | 2.500 leke ne vit |
| | ➢ Per cdo subjekt juridik, privat .shpk,sha, e te ngjashme me keto. | 5.000 leke ne vit |
| | ➢ Per cdo njesi, gurore furrat e gerqeles e tje si keto. | 5.000 leke ne vit |
| | ➢ Per cdo njesi supermarketi. | 5.000 leke ne vit |
| | ➢ Per tregetaret ambulant. | 300 leke ne vit |

*Struktura e ngarkuar per vjeljen e kesaj tarife eshte Sektori i Zhvillimit Ekonomik per njesine Administrative Bashkise Tepelene, per tarifat e familjeve jane sportelet e ujesjelles Kanalizimeve Tepelene, per vjeljen e kesaj tarife ne Njesite e tjera administrative jane vete Njesite administrative*

| 3 | LLOJI I TARIFES | VLERA |
|---|---|---|
| | **TARIFA E GJELBERIMIT** | |
| | ➢ Cdo familje në njësinë administrative Bashkia Tepelene | 100 leke ne vit |
| | ➢ Cdo familje në njësinë administrative Qender | 0 leke ne vit |
| | ➢ Cdo familje në njësinë administrative Kurvelesh | 0 leke ne vit |
| | ➢ Cdo familje në njësinë administrative Lopes | 0 leke ne vit |
| | ➢ Cdo institucion shteteror,shoqate jofitim prurese e te ngjashme. | 5.000 leke ne vit |
| | ➢ Per cdo njesi, dyqan mishi, peshku, bulmet, perime, mallra konsumi,materjale ndertimi, profesionet e lira farmaci, klinik dentare, hotele, lavazho, gomist etj si keto. | 2.500 leke ne vit |
| | ➢ Per cdo njesi, me aktivitet, kontabilist,avukat,noter, kancelari, kinkaleri, bizneset e artit, shitje rroba e te ngjashme me keto. | 2.500 leke ne vit |
| | ➢ per cdo njesi bar restorante, bar kafe e te ngjashme me leto. | 2.500 leke ne vit |
| | ➢ shoqerite e sigurimeve dhe transferta parash dhe te ngjshme me keto. | 2.500 leke ne vit |
| | ➢ Per cdo subjekt juridik, privat .shpk,sha, e te ngjashme me keto. | 5.000 leke ne vit |
| | ➢ Per cdo njesi, gurore furrat e gerqeles e tje si keto. | 5.000 leke ne vit |
| | ➢ Per cdo njesi supermarketi. | 5.000 leke ne vit |
| | ➢ Per tregetaret ambulant. | 300 leke ne vit |

*Struktura e ngarkuar per vjeljen e kesaj tarife eshte Sektori i Zhvillimit Ekonomik per njesine Administrative Bashkise Tepelene, per tarifat e familjeve jane sportelet e ujesjelles Kanalizimeve Tepelene, per vjeljene kesaj tarife ne Njesite e tjera administrative jane vete Njesite administrative.*

| 4 | LLOJI I TARIFES | VLERA |
|---|---|---|
| | **TARIFA E PARKIMIT** | |
| | ➢ Per cdo automjet per udhetar apo automjet transport malli ne vendet e parkimit me pagese . | **50 leke ora.** |
| | ➢ Per cdo automjet per udhetar apo automjet transport malli qe pajiset nga bashkia me license apo me certifikate nga Bashkia Tepelene, tarifa e parkimit per cdo raste. | **5.000 leke ne vit** |

*Struktura e ngarkuar per vjeljen e kesaj tarife ehste Sektori i Zhvillimit Ekonomik per njesine Administrative Bashkise Tepelene.*

| 5 | LLOJI I TARIFES | VLERA |
|---|---|---|
| | **TARIFE E ZENIES SE HAPSIRAVE PUBLIKE**<br>• Për tregëtim në tregje publike të miratuara nga bashkia të artikujve ushqimore, fruta – perime, vezë, mish,peshk, bulmet, kafshë të imta dhe të trasha e.t.j<br>• Për organizim evente të ndryshme, panaire, tregëtim në hapësira publike.<br>• Për zënien e hapësirave publike për shërbim me tavolina, **UJI I FTOHTE**<br>• Për zënien e hapësirave publike për qëllim biznesi qytet /Tepelenë<br>• Për zënien e hapësirave publike për qëllim biznesi Njësi Administrative/Tepelenë | **50 leke/ m2.**<br>**40 lekë/m2/ ora**<br>**200 lekë/ m2**<br>**100 lekë/m2**<br>**60 lekë/m2** |

*Baza e takses se zenies se hapsirave publike eshte siperfaqia ne $m^2$ e cila vihet ne shfrytezim nga individe dhe subjekte per qellime biznesi.Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksa paguesit duke shumezuar bazen e takses ( siperfaqen) me nivelin tregues te saj.*

*Struktura e ngarkuar per vjeljen e kesaj takse Sektori i Zhvillimit Ekonomik (Tatim-Taksa) prane Bashkise Tepelene dhe për Njesite administrative Qender, Kurvelesh dhe Lopes do te mblidhen respektivisht nga keto njesi administrative.*

| 6 | TARIFË PËR TAVOLINA JASHTË LOKALEVE | VLERA |
|---|---|---|
| | ☐ Për muajt Janar, Shkurt, Mars, Nëntor dhe Dhjetor<br>☐ Për muajt Prill – Tetor | 20 lekë/ditë/tavolinë<br>50 lekë/ditë/tavolinë |

| 7 | TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONAT PUBLIKE | VLERA |
|---|---|---|
| | • për njësinë administrative Tepelene(qytet)<br>• për njësitë administrative të tjera | 220 lekë/m2 në muaj<br>110 lekë/m2 në muaj |

| 8 | TARIFË PËR MIRËMBAJTJEN E VARREZAVE PUBLIKE | |
|---|---|---|
